



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.890/3 prot.

Pukë, më 04 .06 .2025

PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
date 03 .06 .2025

Në mbështetje të ligjit nr.**139/2015**, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 4 datë 26.05.2025, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë u zhvillua me datën **03 .06 .2025**, ora **13-⁰⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite: :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 18.04.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Mars** 2025.
3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Prill** 2025.
4. Projekt- vendime : Për vlerësimin me titullin " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë të z. Agron Keçani"
5. Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Lavdie Terbuni, pergjegjese e zyres sociale, Lindita Hyseni drejtore e menaxhimit te territorit, Sokol Gjoni , drejtor i burimeve njerezore , po moren pjese edhe nje grup te rinjesh nga Levizja rinore Puke., Mark Kol Gjegji , qytetar.

Mbledhja filloi ne oren 13:25, se erdhen me vonese keshilltaret . Jane prezent ne mbledhje 8 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka hapi mbledhjen dhe prezantoi projekt-rendin e dites te miratuar nga kryesia.

U hodh ne votim dhe u miratua rendi i dites me 8 vota pro, 0 ,vota kunder, 0 vota abstenim.

1. Mbledhja vijoi me **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 18.04.2025**

U hodh ne votim dhe u miratua **procesverbali i mbledhjes së dates 18.04.2025** me 8 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Mars** 2025.

Pyetje : Gj. Gjoka : A eshte shtuar numri apo a jane hequr familje?

Sqaron : Lavdie Terbuni: Jane familjet qe nuk jane perfituese ne sistemin e pikezimit, kryesisht familje me nje anetare. Ne muajin Mars ka pak me shume se ne muajin Prill, sepse ndonje mund te jete angazhuar ne pune sezonale.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Mars** 2025. me 8 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

3. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Prill** 2025.

Pyetje : Gj. Gjoka : A eshte shtuar numri apo a jane hequr familje?

Sqaron : Lavdie Terbuni: Jane familjet qe nuk jane perfituese ne sistemin e pikezimit, kryesisht familje me nje anetare. Ne muajin Mars ka pak me shume se ne muajin Prill, sepse ndonje mund te jete angazhuar ne pune sezonale

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Prill** 2025. me 8 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

4. Projekt- vendime : Për vlerësimin me titullin ” Qytetar Nderi” i Bashkisë Pukë të z. Agron Keçani”

Pyetje: nuk ka

Sqaron : Sokol Gjoni :Bashkia Puke ka sjell projekt-vendimin per vleresim me titullin ”Qytetar nderi”te z. Agron Keçani. Eshte nje njeri humanist, ka mbeshtetur shume familje ne veshtersi ekonomike, ka ndihmuar shume institucione, eshte angazhuar per ndertimin e nje kendi lojrash ne Puke. Ka qene nje nga nxitesit per binjakezimin e Bashkise me Komunen e Signes ne Itali. Eshte miratuar dhe nga komisioni keshillimor per vleresimin me tituj e medalje.

Enver Sulejmani: Kam kenaqesine te jeme ne keshille per t’i dhene titullin ”Qytetar Nderi” z. Agron, ketij djali pukjan, qe se ka harruar asnjehere vendlindjen. Eshte ne nderin e keshillit per ta nderuar.

Gjon Gjoka : Kerkoj qe te plotesohen dokumentat sipas rregullores , qe kemi miratuar ne keshill, per te gjitha rastet, qe paraqiten ne keshill per vleresim me titull nderi. Agron i ploteson kushtet dhe eshte ne nderin tona ta nderojme.

Ndue Lalaj: Kam respekt dhe mirenjohje per per kete humanist dhe mbeshtetes per njerezit ne nevoje.

U hodh ne votim dhe u miratua vleresimi me titullin " Qytetar Nderi" i Bashkisë Pukë te z. Agron Kecani" me 8 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

5. Te tjera:

Kerkese e z. Mark Kol Gjergji, banues ne Dedaj, Kerkon hapjen e nje rruge.U lexua kerkesa nga kryetari i keshillit,

Enver Sulejmani : A ju ka drejtuar Bashkise dhe cili eshte reagimi?

Mark Kol : Gjergji: Kam bere kerkese edhe Bashkise edhe keshillit. Rruga eshte e hapur, po jane tre familje qe me pengojne per te kaluar. Kam bere disa perpjekje por pa rezultat. Kane ardhur perfaqesues te Bashkise dhe me kane thene se do ta shohim , por deri tani asgje.


Arben Guga: Kjo rruge ka vite qe ka probleme , duhet me u zgjidh.

Gjon Gjoka: Te punohet nga kryesia e fshatit dhe ne bashkepunim me administraten te zgjidhet ky problem.


Enver Sulejmani : A ke biseduar me familjet penguese dhe cfare pretendojne?

Mark Kol Gjergji : Nuk kane pretendime , por nuk me lene me kalu.

Gjon Gjoka: Te vijohet puna e administrates per zgjidhjen e ketij problemi dhe te vine me propozime konkrete.


Enver Subjani


GZON GZOKA


Besnik Peci


Adul Lolej Dumej
Shpresa Pemej 



Aleksander Troshu 

Shkretari i bashkisht
Haxhi Tahir
